



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 07.03.2014

PËR

**MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR QENDRËN E
PRODHIMIT TË INDUSTRIË FARMACEUTIKE, KOMUNA BUBQ, QARKU
DURRËS**

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e qendrës së prodhimit të industrisë farmaceutike, Komuna Bubq, qarku Durrës, me subjekt zhvillues “Elira-Gent Al Pharma” sh.p.k.
2. Bashkëlidhet harta e planvendosjes së strukturave, si pjesë përbërëse e Lejes Zhvillimore Komplekse.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet kërkuesit vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë pranë Njësisë Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDIRAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENI

Egjeni

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. ILIR BEQAJ

MINISTËR I SHËNDETËSISË



SEKRETARE E KKT

Znj. ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT